



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL**

Nr. 11243-00639-00-2013 i Regj.Themeltar

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, të përbërë nga

ARTUR KALAJA	Kryesues
MARGARITA BUHALI	Anëtar
DARJEL SINA	Anëtar
ENTON DHIMITRI	Anëtar
ERVIN PUPE	Anëtar

Sot më datë 16.11.2022 mori në shqyrtim çështjen që u përket:

Paditës: Nuri Hasa

I paditur: Shoqëria Banka Credins sh.a.

Person i tretë: 1. Përmbarues gjyqësor Kastriot Kurmaku
2. Shoqëria Italdruri Elbasan sh.p.k

Objekti: Shuarjen e dorëzarisë së paditësit Nuri Hasa në “*Marrëveshje kredi nr. 256, datë 3.7.2009*”, nr. 2059 rep., nr. 618/1 kol., datë 17.07.2009, lidhur ndërmjet shoqërisë Banka Credins sh.a dhe shoqërisë Italdruri sh.p.k.

Baza Ligjore: Nenet 32/a të Kodit të Procedurës Civile; neni 600 i Kodit Civil.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Artur Kalaja dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 529, datë 27.01.2012 ka vendosur: “*Rrëzimin e padisë së paditësit Nuri Hasa si të pambështetur në ligjë e në prova. ...*”.
2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2364, date 10.10.2012 ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr 529, datë 27.01.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*”. Kjo gjykatë arsyeton njëllor sikundër gjykata e rrethit gjyqësor.
3. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin datë 1.6.2016 ka vendosur: “*Kalimin e*

çështjes nr. 11243-00639-00-2013, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore.”.

4. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin datë 4.11.2022 kanë vendosur: *“Kalimin e çështjes civile nr. 11243-00639-00-2013 regjistri themeltar, datë 5.3.2013 regjistrimi për shqyrtim pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me qëllim njësimit e praktikës gjyqësore”*

5. Në referim të nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi i Kolegjit Civil për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruara për njësim, si dhe u komunikohet palëve ndërgjyqëse, përveç publikimit të tij në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 481 të K.Pr.Civile, i ndryshuar

V E N D O S I

1. Të caktojë datën 15 dhjetor 2022, për shqyrtimin në seancë gjyqësore publike, të çështjes civile nr. 11243-00639-00-2013 regjistri themeltar, datë 5.3.2013, me qëllim njësimit e praktikës gjyqësore.

2. Në zbatim të nenit 481, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, çështjet e shtruara për njësimit e praktikës gjyqësore janë:

-A barazohet kërkesa për lëshim urdhëri ekzekutimi me padinë referuar nenit 600 të Kodit Civil?

-Referuar neneve 597, 598, 599 dhe 600 të Kodit Civil, a legjitimohet dorëzanësi të kërkojë shuarje dorëzanie?

-Afatit 6 mujor është afat prekluziv apo afat parashkrimi (neni 600 KC)?

-Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të KC, a barazohet cilësia e dorëzanësit me atë të debitorit? Nëso po, gjatë cilës fazë mund të barazohen këto dy cilësi?

3. Ky vendim publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

4. Në zbatim të nenit nenit 481, paragrafi i pestë i Kodit të Procedurës Civile ngarkohet sekretaria gjyqësore t'i komunikojë palëve ndërgjyqëse një kopje të këtij vendimi.